



A2023052670068623393

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANE**

Nr. 1674 Rep.

Nr. 619 Kol.

Taksë pulle 200 lek u likuidua!

**AKTI I THEMELIMIT**

**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"ETERNUM" SH.P.K**

Sot, më datë 20.10.2023 (dy mijë e njëzetë e tre), para meje Noter TERENS N. KURTI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga KONT URANI Nr.1, u paraqiten personalisht:

**THEMELUESIT:**

Alda Shehi, atësia Edmond, amësia Merita, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Xhanfize Keko; Nd. 83; H. 1; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 29/08/1991, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte nr. BG5886718 dhe nr. personal J15829045E.

Alesja Haka, atësia Fatmir, amësia Miranda, shtetase Shqiptare, lindur në Krujë dhe banuese në KRUJË, me adresë Punetori 00860171; Nd. 7; H. 1; Ap. 3; Fushë-Krujë; Fushë Krujë; 1502; Krujë, lindur më 26/03/2001, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike pér të vepruar, pér identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033529032 dhe nr. personal K15326067F,

Të lartpërmendurit janë madhor, me zotësi të plotë juridike pér të vepruar, të cilët në cilësinë e ortakëve themelues, bazuar në "Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë", "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligji Nr.9723, datë 3.5.2007 ;Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, Ligji nr. 131/2015 "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit", Ligji "11/2018 "Për Noterinë" i ndryshuar, kërkuan redaktimin e aktit të themelimit, të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Eternum" sh.p.k, me përbajtje si më poshtë:

**KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emertimi:** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "ETERNUM" sh.p.k.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqëria "ETERNUM" sh.p.k. është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga ortakët themelues të lartpërmendur, të cilët nuk përgjigjen pér detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë vetem deri në pjesën e pashtyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve pér detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.



A2023052670065623393

Secili ortak gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

### Neni 3

#### Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën "Tiranë, Rruga Konferenca e Pezës, ZK. 8230, Nr. pasurie 7/139".

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqësie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### Neni 4

#### Objekti

Shtëpi funerale. Organizim i ceremonive mortore.

### Neni 5

#### Kohezgjata

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

### KREU II KAPITALI

### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **10.000 lek (Dhjetë mijë lek)** dhe është i përbërë nga 2 kuota.

Kapitali i mesiperë nënshkruhet dhe shlyet tërësisht ne te holla nga ortakët e shoqërisë perkatesisht :

**ALDA SHEHI** zotëron 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 5.100 lek, që përbën 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**ALESJA HAKA** zotëron 1 kuotë, me vlerë të përgjithshme 4.900 lek, që përbën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpérblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë kontrata duhet të bëhet me shkrim.



A2023052670068623393

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës se cilesuar që kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet trashëgimisë.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**

**Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimit;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimit;
- é) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9**

**Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve



A2023052670068623393

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 10 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqerise do te jetë **Znj. Alda Shehi**, e cila do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riparterite.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkcesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë QKB.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

### Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dérgojnë të dliénat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.



A2023052670068623393

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

**Neni 12**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

**Neni 13**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në QKB;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

**Neni 14**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 15**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ngarkohet dhe autorizohet **Administratori Znj. Alda Shehi** per depozitim te akteve prane QKB.

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterine", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKËT THEMELUES  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ETERNUM" sh.p.k  
ALDA SHEHI ALESJA HAKA

Alda Shehi Alesja Haka

NOTER  
TERENS KURTI